



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Ac.nr.1407/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Zenel Leku, kryetar i kolegjit, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi - anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.G. nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, të cilin me autorizim e përfaqëson S.K., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK – sh.a), me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1531/2019, datë 03.10.2019, në seancën jo publike të mbajtur me datë 27.09.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a (KEK) me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1531/2019, datë 03.10.2019, dhe gjykohet si në vijim: REFUZHET kërkesëpadia e paditësit A.G. nga fshati Komuna e Prishtinës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a me seli në Prishtinë, që në emër të tri pagave jubilarë, t’ia paguajë paditësit shumën prej 1.881,00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 269 euro, e të gjitha këto në afat në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë, SI E PABAZUAR.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1531/2019 të dt.03.10.2019, ka vendosur si në vijim: “ I.APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.G. nga fshati ..., Komuna Prishtinë. II. DETYROHET e paditura Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar, t’ia paguaj 3 (tri) paga mujore, në shumë të përgjithshme prej 1.881.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 03.10.2019, kur është marr aktgjykimi deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 269.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar dhe aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, me refuzimin e kërkesëpadisë si të pa bazuar.

Ankesa i është dërguar në mënyrë të rregullt të autorizuarit të paditësit, por i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi A.G. nga fshati Komuna e Prishtinës, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, me datë 17.05.2019, ka ushtruar padi, të precizuar më vonë gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, ndaj të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës, me seli në Prishtinë, për kompensimin e pagave jubilarë, duke kërkuar që të aprovohet padia dhe kërkesëpadija e paditësit si e bazuar dhe të detyrohet Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a Prishtinë, në emër të shpërblimit jubilar, t'ia paguaj paditësit shumën prej 1.881.00 euro, me kamatë ligjore në lartësi prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Si dhe shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.1531/2019 të dt.03.10.2019, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në pozitën teknik i Makinerisë, në Departamentin Mirëmbajtja Mekanike e TCB, Divizioni Termocentrali Kosova B dhe po ashtu nuk ishte kontestues fakti se paditësi deri me dt. 26.07.2019, ka arritur përvojë pune prej 38 vite, 8 muaj e 8 ditë, kjo e vërtetuar edhe në bazë të kontratës së punës nr. 4831/10 e dt.01.03.2018 dhe kartelës së punëtorit nr.4831 e dt. 26.07.2019. Gjykata nga provat e administruara gjeti se të njëjtut nuk i janë paguar pagesat për shpërblim jubilar në vlerën e tri pagave mujore, edhe pse një obligim i tillë është paraparë me nenin 52 par 1 nën par 1.3 dhe par 2 dhe 3 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës. Ka vlerësuar se në rastin konkret paditësi ka me tepër se 30 vite përvojë pune, andaj ka vlerësuar se i njëjti i ka plotësuar kushtet e parapara për pagesën e shpërblimit jubilar, në vlerën e tri pagave mujore në kohën kur marrëveshja e lartcekur ka qenë në fuqi. Ka shtuar se kompensimi i pagave jubilarë është paraparë edhe me Kodin e Punës të së paditurës me numër të protokollit 1041 të dt. 05.06.2015, përkatësisht nenin 53.4 të këtij kodi. Për lartësinë e pagës mujore, është bazuar në nenin 5 të Kontratës së punës nr. 4831/0 të dt. 01.03.2018.

Gjykata e shkallës së parë bazuar në nenin 245 par 1 të LMD-së ka vlerësuar se mes palëve është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka rolin e kreditorit, ndërsa e paditura të debitorit, dhe se e paditura duke mos e kryer detyrimin e saj, i ka mbetur borxh paditësit për

pagesën e tri pagave për shpërblimin jubilar. Gjykata pretendimet e të paditurës se paditësi e ka ushtruar padinë pas afatit ligjore, nuk i mori si të qëndrueshme, për faktin se e paditura ka dështuar t'ia paguaj paditësit shpërblimin jubilar, edhe përkundër faktit se paditësi derisa ka qenë në fuqi marrëveshja Kolektive e Kosovës, i ka plotësuar kushtet për pagesën e shpërblimit jubilar dhe se vet e paditura me vendimet e saj iu njeh të drejtën në shpërblim jubilar të gjithë të punësuarve. Ka vlerësuar se fakti se paditësi ka më shumë se 30 vite përvojë pune, nuk paraqet asnjë pengesë që i njëjti ta realizoj të drejtën e tij bazuar në nenin 52 par 1 nën par 1.3 të MPKK –së, dhe se në rastin konkret mjafton që i njëjti në kohën sa ka qenë në fuqi MPKK ka pasur më shumë se 30 vite përvojë pune dhe se interpretimi ndryshe do të paraqiste diskriminim në mes të punësuarve tek i njëjti punëdhënës, kur dihet se marrëveshjet kolektive nuk mund të zgjasin më shumë se 3 vite. Për kamatën ka vendosur duke u mbështetur në nenin 382 të LMD –së, ndërsa për shpenzimet konform nenin 449 dhe 452 të LPK –së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht prandaj aktgjykimi është ndryshuar.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, me qenë se gjykata e shkallës së parë gabimisht i është referuar nenit 52 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive të datës 01.01.2015 dhe po ashtu gabimisht ka interpretuar Institutin e parashkrimit në këtë rast. Nga provat e administruar e posaçërisht Kartela e punëtorit nr. 4831, vërtetohet se paditësi vitin jubilar ose vitin e 30 të përvojës së punës si kusht për të kërkuar kompensimin e tri pagave jubilarë e ka arritur para vitit 2015 kur Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka hy në fuqi. Paditësi me datë 02.04.2019 ka paraqitur kërkesë të e paditura për kompensimin e pagave, mirëpo kërkesa i është refuzuar ndër të tjera edhe me arsyetim se kërkesa është parashkruar.

Për të vendosur lidhur me këtë çështje Gjykata e Apelit i është referuar dispozitave nga neni 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të punës, me të cilën përcaktohet se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, ndërsa me nenin 357 të Ligjit nr. 04/1-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, përcaktohet se: “Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijani për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin. Në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vite nga shkaktimi i dëmit”.*

Mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar dispozitat e sipërcituara Gjykata e Apelit vlerëson se kërkesa e paditësit për kompensim e tri pagave jubilarë është parashkruar, kjo pasi që paditësi ka fituar bazën juridike për të kërkuar kompensimin e tri pagave jubilarë me hyrjen

në fuqi të Marrëveshjes Kolektive – datë 01.01.2015, ku konsiderohet se nga kjo kohë kërkesa e paditësit është bërë e arritshme, ndërsa gjykatës i është drejtuar me padi për kompensime pagave jubilarë me datë 17.05.2019, që do të thotë se deri tek paraqitja e padisë kanë kaluar me shumë se tre vite. Duhet pasur parasysh se me nenin 53 par. 3 të kësaj marrëveshje është përcaktuar se shpërblimi i pagave jubilarë paguhet në afat prej një muaji pas plotësimit të kushteve, ndërsa marrë për bazë përvojën e punës së paditësit rezulton se këtë kusht paditësi e ka plotësuar para se të hyj në fuqi marrëveshja, mirëpo meqë nuk ka pasur bazë ligjore në kohën e plotësimit të kushteve për paga jubilarë, atëherë afati është dashur të llogaritet nga hyrja në fuqi të marrëveshjes përkatësisht nga data 01.01.2015. Konsiderohet se nga kjo datë ka rrjedhur afati i parashkrimit të kërkesës, ndërsa nga kjo datë e deri në paraqitjen e padisë kanë kaluar më shumë se katër dhe gjykatës nuk i është prezantuar ndonjë dokument apo kërkesë me të cilën paditësi t'i jetë drejtuar të paditurës për realizimin e pagave jubilarë e që do të ndërprente afatin e parashkrimit.

Kjo gjykatë vlerëson se kërkesa e paditësit drejtuar të paditurës për kompensim të pagave nuk mund të ketë për efekt ndërprerjen e afatit të parashkrimit, ngase e njëjta kërkesë është dorëzuar tek e paditura pasi që realisht ishe arritur koha e parashkrimit. E paditura ka marr vendim me të cilin është përcaktuar zgjidhja që të punësuarve që kanë arritur përvojën e punës 10; 20; 30, të ju njihen pagat jubilarë, mirëpo ky vendim nuk mund të ketë asnjë ndikim në raport me kërkesë e paditësit ngase paditësi një të drejtë të tillë e kërkon pas arritjes së moshës prej 37 viteve.

Nga arsyet e paraqitura Gjykata e Apelit ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar dhe ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës është marr duke u mbështetur në dispozitat nga neni 450 i LPK - së, për arsye se e paditura gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk i ka kërkuar shpenzimet e veta të procedurës.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1, pika (e) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 1407/20, me datë 27.09.2021

Kryetar i kolegjit
Zenel Leku